



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
SENATI AKADEMIK

Nr. 135/1 Prot.

Tiranë, më 30/01/2024

**VENDIM**

Nr. 7, DATË 30/01/2024

**MBI**

**“MIRATIMIN E FORMËS DHE PËRMBAJTJES SË DIPLOMËS PËR  
PROGRAMIN E STUDIMIT ME KOHË TË PLOTË “BACHELOR NË  
FOTOGRAFI” NË FAKULTETIN E ARTEVE TË BUKURA, UNIVERSITETI I  
ARTEVE”**

Mbështetur në nenin 38 , pika 3 si dhe nenin 91, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Udhëzimin Nr. 10, datë 30.03.2020, “Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, Kreu II, pika 2 e tij, si dhe nenin 89, pika 5 dhe 6 të Statutit të Universitetit të Arteve, Senati Akademik i Universitetit të Arteve me votim të hapur,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e formës dhe të përmbajtjes së diplomës për programin e studimeve me kohë të plotë, të ciklit të parë “Bachelor në Fotografi”, në Fakultetin e Arteve të Bukura, sipas modelit bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Një kopje e këtij vendimi t'i përcillet për procedura të mëtejshme Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA).

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Asoc. Dr. Artan IBËRSHIMI

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Dr. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Zamir KOKONOZI

Prof. Asoc. Genci FUGA

Erlind FUSHA (Student FAB)

Sindi ZDRAVA (Studente FM)



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA  
DEKANI

Nr. 135 Prot

Tiranë, më 29 01 2024

**Lënda:** Përcillet propozimi për formën dhe përmbajtjen e diplomës për programin e studimit “Bachelor në Fotografi”

**REKTORIT, UART**  
**Prof. Kastriot ÇAUSHI**

*I nderuar,*

Bazuar në propozimin e ardhur nga Njësia Bazë “Arte të Aplikuara”, bashkëlidhur Ju dërgoj për miratim në Senatin Akademik të formës dhe përmbajtjes së diplomës që do të lëshohet në përfundim të programit të studimeve të ciklit të parë Bachelor në Fotografi, me kohë të plotë, në vijim të procedurës së përcaktuar në Udhëzimin nr. 10, datë 30.03.2020 “Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

**Prof. Artan PEQINI**

**DEKANI**  
**FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA**





REPUBLIKA E SHQIPERISE



# UNIVERSITETI I ARTEVE

## FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA

Në përfundim të programit të studimeve të ciklit të parë Bachelor, me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, me 180 kredite (ECTS), në përputhje me Nivelin 6 (gjashtë) të KSHK, i jep diplomën:

# BACHELOR në FOTOGRAFI

Lindur në \_\_\_\_\_

më 01.01.2020 me numër matrikullimi \_\_\_\_\_

Numri i maturës shtetërore \_\_\_\_\_

Numër unik identifikimi \_\_\_\_\_

Diploma shoqërohet me suplementin e saj

Numri i diplomës \_\_\_\_\_

Data e mbrojtjes së diplomës \_\_\_\_\_

Data e lëshimit të diplomës \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_  
DEKANI

\_\_\_\_\_  
REKTORI



